

Serbia dhe Kosova Kultura pakufi

Gjatë vitit 2015, me përkrahjen e Bashkimit Evropian, Komitetit i Helsinkit për të drejtat e njeriut nga Srbija në bashkëpunim me organizatën Qendra Liberal Demokrate nga Kosova kanë filluar projektin

“Srbija dhe Kosova kultura pa kufinj”.

Ideja ka qenë që të kontribuojmë zhvillimit të lidhjeve në fushën e kulturës në mes të Beogradit dhe Prishtinës dhe zhvillimit të lidhjeve të rrjeteve të reja të njerëzve të rinj, grupeve akademike dhe artistike dhe shoqërisë civile nga Beogradi dhe Prishtina. Kemi mëtuar që përmes kulturës dhe artit të përkrahim implementimin e marrëveshjes së Brukselit në mes të Beogradit dhe Prishtinës duke promovuar aktivitetet e përbashkëta të artistëve të rinj dhe duke ndihmuar në zhdukjen e prargjyqimeve stereotipe për njëri tjetrin tek Shqiptarët dhe Serbet.

Më tepër se njëqind artistë nga Beogradi dhe Prishtina kanë marrë pjesë në seminarin, ligjeratat dhe punëtoritë tona.

Kanë vizituar institucione të kulturës, ngjarje kulturore, festivale në Prishtinë, Prizren dhe Beograd dhe çka është më e rëndësishmja kanë krijuar akcione dhe fushata të përbashkëta artistike.

Gjatë festivalit Muaji i Prishtinës në Beograd të cilin e kemi organizuar në muajin qershor dhe festivalin Muaji i Beogradit në Prishtinë në Gusht dhe Shtator publiku Beogradas dhe ai i Prishtinës në lokacione të ndryshme kanë qenë pjesë e aktiviteteve

kulturoro-artistike si: filmat e metrazhit të gjatë dhe të shkurtër, ekspozita dhe ngjarje muzikore. Artistët të cilët janë të prezantuar edhe në këtë shtojcë kanë marrë pjesë në ngjarjet e festivalit. Shumica e artistëve kanë performuar ose kanë ekspozuar për herë të parë në Prishtinë e disa të tjerë madje për herë të parë i kanë vizituar këto qytete.

Përveç asaj që publika është njohtuar për herë të parë me skenën kulturore dhe artistike të dy qyteteve ndoshta rëndësi më të madhe ka fakti që artistët e rinj nga dy vendet janë njohtuar, kanë shkëmbyer ide dhe mendojnë për bashkëpunim të mëtutjeshëm. Ka edhe iniciative të tjera që e promovojnë bashkëpunimin kulturor dhe artistik në mes të dy shoqërive përveç këtij projekti.

Por kësi iniciative nuk ka mjaft. Është me rëndësi që numri i këtyre iniciativave të shtohet, që sa më shumë artistë nga Prishtina të vizitojnë Beogradin dhe anasjelltas, që institucionet e kultures të fillojnë të organizojnë kësi lloj ngjarjesh dhe që artistët e skenës kulturore të Prishtinës të bëhen pjesë e skenës kulturore të Beogradit dhe anasjelltas.

Ky projekt financohet nga

Delegacioni i BE-se në

Srbi përmes programit “Përkrahje Shoqërisë civile”

Jelena Džombić

Koordinatorë e programit

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Srbi



Serbia dhe Kosova Kultura pa kufinj



Kantautorja serbe, Ana Qurçin performon në Prishtinë në kuadër të festivalit “Muaji i Beogradit në Prishtinë”

Kantautorja serbe, Ana Qurçin, i është rtkthyer Prishtinës gati pas një viti. Në një ambient jo fort të madh ka mbledhur disa të rinj ku për afro një orë ka kënduar këngët me tekste të veta.

Në shoqërimin e Marko Cvetkoviqit në bas-kitarë, Luka Slaviqit në miksetë e Goran Grubishiqit në tupana, Qurçin gjatë gjithë kohës sa ka kënduar, ka luajtur edhe në kitarë. Këngët e saj “Alone” e “Keep quiet” të cilat i ka kënduar gjatë mbrëmjes, janë tipike të stilit të saj muzikor indie-rock dhe folkut amerikan. Qurçin, që njihet për një zë specifik, gjatë gjithë kohës ka argëtuar të pranishmit me këngët që do të jenë pjesë e albumit të saj debutues i cili pritet të dalë në treg në fund të këtij viti. Këngëtarja nga Beogradi ka performuar në kuadër të “Muajit të Beogradit në Prishtinë”, që është organizuar nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Beograd dhe Qendra Liberal - Demokrate në Prishtinë. Aktiviteti me moton “Intercultural Icebreakers” (Thyerja e akullit ndërkulturor), është mbyllur me performancën e Qurçinit, e cila e ka nisur aktivitetin e vet muzikor në dhjetor të vitit 2012, ku pos turneve nëpër vendet ballkanike është prezantuar edhe në Austri, Itali, Zvicër e Rusi. Këngët “Unknown” dhe “Silence” kanë qenë pjesë e “menysë” së Qurçinit për Prishtinën. Edhe pse numri i atyre që kanë përcjellë koncertin nuk ka qenë i madh, ajo ka arritur të tërheqë goxha vëmendje.



“Zëri i saj është madhështor. Ndoshta më duket kështu sepse e pëlqej këtë lloj muzike, por me të vërtetë ishte tejet tërheqëse”, ka thënë Merita Gashi, studente e Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës.

Për qëllimin e organizimit ku pretendohet që të thyhen barrierat kulturore midis Serbisë dhe Kosovës, Gashi ka thënë se në art nuk duhet të ketë kufij të tillë. “Arti është diçka të cilit nuk i pëlqejnë apo, thënë më mirë, nuk i njeh kufijtë”, ka thënë ajo. E vetë Qurçin pas koncertit ka treguar se këngët me të cilat është prezantuar në Prishtinë e shoqërojnë atë në të gjitha koncertet. “Ndihem mirë që jam në Prishtinë. Atmosfera ishte dinamike”, ka thënë këngëtarja. Nismat për të bashkuar artistët serbë me ata shqiptarë i konsideron si një hap të madh drejt së ardhmes. “Nuk di të them diçka sa i përket asaj se a duhet harruar e kaluara, por e di që duhet ta pranojmë njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojmë”, ka thënë Qurçin. Sipas saj, zhvillimi i marrëdhënieve të mira midis dy popujve e sidomos kur ata janë fqinjë është shumë i rëndësishëm.

Është diçka speciale për mua të performoj në Prishtinë dhe muzika nuk ka ndonjë kufi. Kjo është qasja me të cilën duhet t’u hyjmë këtyre punëve. E vlerësoj faktin se mund ta bëjmë këtë”, ka thënë ajo, teksa ka shtuar se ka dëshirë të kthehet në Prishtinë. “Më duket pranohem mirë këtu. Kjo është mënyra nëpërmjet së cilës duhet t’i ofrohemi njëri-tjetrit”, ka thënë Qurçin e cila do të jetë mjaft aktive me koncerte deri në fund të vitit. Granit Gashi, koordinatori i projektit “Muaji i Beogradit në Prishtinë” ka thënë se tendenca është që të krijohet një festival vjetor ku artistët e Serbisë e të Kosovës të shkëmbejnë përvojat e tyre. “Qëllimi është të përkrahim artistët e rinj që të krijojnë së bashku sikur ata të Kosovës dhe ata të Serbisë. Tendenca është që artistët të kenë përvoja të përbashkëta dhe të kthehen lidhjet e vjetra”, ka thënë ai. Sipas Gashit, edhe pse është viti i parë i organizimit, pak a shumë ia kanë arritur qëllimit.

“Muaji i Beogradit në Prishtinë” ishte hapur në fund të gushtit me filmin “Nije dete” të regjisorit Vuk Rshumoviq për të vazhduar me debatin “Poezia e grave dhe vlerat patriarkale në Serbi dhe Kosovë”. Pos ekspozitave, janë organizuar edhe tribunat si “Migrimet dhe kultura”, “Jugosllavia si histori - rasti i Kosovës”. Po ashtu është shfaqur filmi “Rabbitland” me regji të Ana Nedeljkoviqit dhe Nikola Majdakut. Me “Muajin e Beogradit në Prishtinë” artistët serbë kanë sjellë një mozaik të kulturës dy muaj pasi këtë e kishin bërë artistët kosovarë në kryeqytetin serb. Në “Muajin e Prishtinës në Beograd”.



Zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit edhe me kulturë

Për një muaj, artistë të ndryshëm nga Kosova kanë shpalosur veprat e tyre në Beograd. Filma, ekspozita, debate e performanca të ndryshme jenë në dispozicion për publikun serb gjatë gjithë muajit qershorit të këtij viti.

Në kuadër të këtij muaji kulturor është shfaqur edhe si premierë në Serbi filmi Ballkoni i regjisoresh së mirënjohur Kosovare Lendita Zeqiraj. Pas shfaqjes së filmit është zhvilluar edhe debati "Kinematografia në Kosovë dhe Serbi: paralelet dhe mundësitë", ku panelistë kanë qenë regjisori Ismet Sijarina, dramaturgu Arian Krasniqi, producenti Bujar Kabashi, dhe dy regjisorët serbë, Ognjen Glavoniq dhe Stefan Filipoviq. Regjisori Filipoviq njëkohësisht ka qenë edhe moderator i këtij debati. Pas tryezës kemi zhvilluar një intervistë me të lidhur me përshtypjet e tij.

Cfare njohurie kishit mbi kinematografine Kosovare para debatit, te zhvilluar pas konfliktit te Kosoves?

Ishta pjesmarres ne festivalin e filmit Skena Up gjate vitit 2014 (2013 mendoj) me filmat (Šišanje/Skinning and Maja Milos's Klip), pra pak a shume kisha njohuri mbi situaten e kinematografise ne Kosove edhe para debatit te tcilit ju e permendet. Filmi i Isa Qosjës Tre Dritare dhe një Varje është filmi i pare i metrazhit të gjatë i realizuar në periudhën e pas luftës në Kosovë, gjatë ketij Qershori. Shfaqjen e kisha parë në Festivalin "Mirdita, Dobar Dan", në Belograd.

Mund te them se prap e ndjeje nevojen e komunikimit ne fushen e teatrit e literaturesse sa ne ate te filmit.

Temat e diskutimit në këtë ngjarje ishin çështjet paralele dhe potencialet e zhvillimit në lidhje me kinematografinë në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në mendimet tuaj, cilat janë çështjet paralele dhe potencialet në këto dy vende?

Ka shumë paralele, pasi që të dyja Serbia dhe Kosova janë duke u përpjekur për të gjetur një vend në konkurrencën e kineastëve të Evropës jug-lindore, shkak u të dyja janë tregje të vogla në krahasim me të mëdhatë, dhe për këtë arsye janë të detyruar t'i drejtohem fondeve shtetërore dhe kooperimeve rajonale. Nëse ju mendoni rreth saj, nuk ka pothuajse asnjë film në këtë rajon që nuk është një formë e një bashkë-prodhimi. Kjo është e mirë, jo vetëm sepse hapë mundësitë e gjetjes së fondeve për filmat evropianë si Euroimages, por, nga edhe nga ana krijuese, ajo gjithashtu inkurajon dialogun kulturor dhe komunikimit, dhe u jep filmbërësve mundësi për të punuar me talentet më të mirë të rajonit. Sigurisht, kjo ndodhë edhe fakti se ne të ndajmë një pjesë shumë të madhe të historisë dhe kulturës së ndërsjellë, shkak u që kemi jetuar në një vend të njëjtë për dekada të tëra.



A ka ndonjë potencial të vërtetë të bashkëpunimit mes kineastëve të rinj nga Kosova dhe Serbia?

Absolutisht, jo vetëm një potencial, por një përgjegjësi mbi brezat e rinj të filmbërësve për të bashkëpunuar, dhe për të ndërtuar ura ku etërit tanë I kan djegur. E vetmja mënyrë për të bërë këtë është përmes komunikimit, dialogut, dhe përpjekjeve për të kuptuar perspektivat e ndryshme. Por, jo të gjithë filmat duhet të banojnë mbi të kaluarën. Gjeneratat e reja kanë tema dhe shqetësimet e tyre, dhe duhet të bëjnë filma që duan, jo të orientohen nga ato që "priten" prej tyre!

Ju kujtohet ndonjë film nga Kosova ose aktorë të përfshirë me origjinë nga Kosova, ose krijimtari tjera nga Kosova që ishte prodhuar në Jugosllavi? Nëse po, çfarë mendoni për këto vepra?

Gjëja e parë që mbin në mendje janë të gjitha filmat e të ndjerit, Bekim Fehmiu. Por një shumë e filmave të ish-Yu kanë paraqitur talentin nga Kosova - jo vetëm aktorë, por teknikë, regjisorë, ekuipazhit të filmave, dhe kështu me radhë. Ne thelb, ne kemi shpikur konceptin e bashkë-prodhimit modern European në ish-Yu! :)



Ekspozitë e artistëve nga Beogradi në Prishtinë

Artistët Marko Stojanović, Ksenija Jovišević i Marko Crnobrnja kanë ekspozuar për herë të parë në Prishtinë. Në natën e hapjes poashtu kishin mundësi që të shkëmbenin përvoja dhe mendime me kolegët dhe artdashësit Kosovar që kishin mbushur hapësirën e galerisë së fakultetit të arteve në PrishtinëTËT. Marko Stojanović ka prezantuar shtatë fotografi nga seria “Qyteti Cilido” të cilat janë më parë ishin ekspozuar në Beograd. “Për herë të parë jam duke ekspozuar në Prishtinë dhe në Kosovë, këtë emër të cilin e kam ndëgjuar më shpesh se emrin tim. Kam ekspozuar në dimenzionet lightbox 1 metër katror dhe gjashtë fotografi të formatit më të vogël. Këto janë skena interne nga mjedise urbane. Fotografitë janë të tilla ashtu që nuk mund të paragjykohet lokacioni, janë të liruar poashtu edhe nga nacionalizmi gjeografik. Veprime intime dhe të vogla të njerëzve, veprimet e tyre në kuadër të sistemit të komplikuar të qytetit në të cilin jetojnë” ka pohuar Stojanović lidhur me punimet e tij. Sipas Stojanović, për temën e lightbox është influencuar nga një vitrinë e supermarketit në Negotin, e cila ka qenë një sipërfaqe e madhe nga xhami të cilën pronari i ri e ka mbushur me fotoafragi. Gjithë sipas tij, njerëzit kanë reaguar në këtë ndryshim duke filluar që ta përdorin këtë sipërfaqe si table për shpallje. “Për mua ka qenë shumë interesant se çka ata rekomandojnë. Kemi shpallje të ndryshme e më së shumti shpallje për të vdekurit. Kjo mund të shpjgohet edhe si “Kolera e bardhë” e cila është e evidente në Serbinë lindore dhe me shpërnguljen e përgjithshme të qytetarëve.” Shpjegon Stojanović



Ksenija Jovišević publikut i ka prezantuar punimet e saja nga viti i katërt në fakultet. “Punimet quhen “Parashikimi dhe Ankthi” dhe paraqesin simboliken e subjektit dhe llojin e gjendjes që ndërlidhet me subjektet e dhëna, në këtë rast ora dhe telefoni. Krijimin e arketipeve nga subjekti, dhe vendosja e tyre në kontekst dhe nxjerrja nga konteksti “pohon Jovišević. Ajo shton se do të kthehej me gjithë dëshirë në Prishtinë dhe thekson se ofertën për të ekspozuar këtu e ka pranuar menjëherë, sepse për të ka qenë interesant dhe ekzotike që nga dora e parëtë shoh se si rrjedhin gjërat në Prishtinë.



Puna e Marko Crnobrnje përbëhet nga dy objekte, njëri është vizatimi u automobilin në dërrasë dhe tjetra një biciklist. “Bëhet fjalë për dy punime të cilat janë të ndërlidhura, sepse ndërlidhen me mënyrat e para të lëvizjes për mua, dhe kjo është bicikleta dhe më vonë dëshira për të kaluar provimin e vozitjes. Vetura Jugo e vizatuar në dërrasë në njëfar mënyre është kujtim i përbashkët.

Për mua ka qenë interesant që të prezantoj ish-kompaninë Jugodrho e cila dikur e ka lidhur tërë territorin me rebus skulpturen e cila është joverbale dhe e lexueshme e poashtu në çdo moment mund të jetë aktuale. Ky është objekti i cili në mua e ndoshta edhe tek të tjerët paraqet emocion dhe kujtime në kohërat e kaluara” ka pohuar Crnobrnja.

Kjo ekspozitë ishte pjesë e festivali Muaji i Beogradit në Prishtinë.



Ky projekt financohet në kuadër të programit “Përkrahje shoqërisë civile për Republikën e Serbisë 2013” Qëndrimet e shprehura në këtë shtojcë përfaqësojnë qendrimet e autorëve dhe jo domosdoshmerisht reflektojnë qendrimet e Bashkimit Evropian.



Kjo shtojcë është bashkfinancuar nga ambasada zvicerane në prishtinë

